



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 172 dt.10.10.1996

Këshilli Bashkiak, i mbledhur sot me dt.10.10.1996, për shqyrtimin e relacionit të paraqitur nga Seksioni i Transportit, duke parë të arsyeshme nevojat që ka sot qytetit i Tiranës për trafikun,

**VENDOSI**

1. Të miratojë fondin prej 4.950.000 lekë për kontrollin bashkëkohor të lëvizjes së automjeteve dhe qytetarëve në zonat e nxehta të trafikut në qytetin e Tiranës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria Administrimit Financiar dhe Seksioni i Transportit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**